



## Njoftim mbi shqyrtimin e çmimeve të ngrohjeve qendrore

Zyra e Rregullatorit për Energji njofton se ka për qëllim që më 10 qershor 2008 të fillojë shqyrtimin e çmimeve për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore për sezonin e ngrohjes 2008/2009.

Shqyrtimi i çmimeve do të kryhet duke u bazuar në kompetencat që i jepen ZRRE-së nga Ligji i rregullatorit të energjisë, dhe në përputhje me Udhëzimin për raportimin rregullativ dhe Udhëzimin për parimet e kalkulimit të tarifave dhe çmimeve në sektorin e ngrohjes qendrore. Shqyrtimi i çmimeve do të zhvillohet sipas planit implementues dhe orarit. Udhëzimet, plani implementues dhe orari, si dhe dokumentet tjera të nevojshme gjenden në faqen elektronike të ZRRE-së: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org).

ZRRE-ja i fton të gjitha palët me interes në këtë shqyrtim që të regjistrohen me ZRRE-në, ose përmes e-mailit në [ERO.PRICING-TARIFFS@ero-ks.org](mailto:ERO.PRICING-TARIFFS@ero-ks.org), ose përmes faksit, apo përmes letrës të shënjuar për vëmendjen e Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve apo Ekspertit të Ngrohjes Qendrore. Palët e regjistruara do të lajmërohen kur dokumentet e nevojshme janë lëshuar nga ZRRE-ja.

Propozimet do të pranohen, apo mundësitë për pjesëmarrje publike do të shfaqen gjatë rrjedhës së shqyrtimit të çmimeve.

Regjistrimi do të përfundojë me 4 korrik 2008. Lista e palëve të regjistruara dhe adresat kontaktuese do të publikohen në faqen elektronike të ZRRE-së.

Palët e regjistruara kanë mundësinë për pjesëmarrje publike duke dërguar propozime me shkrim apo komente mbi dokumentet e nevojshme të publikuara apo çështje tjera që kanë të bëjnë me shqyrtimin e çmimit të ngrohjes qendrore. Çdo palë që dëshiron të bëjë propozime ftohet që t'i dërgojë këto ZRRE-së, ose përmes emailit në [ERO.PRICING-TARIFFS@ero-ks.org](mailto:ERO.PRICING-TARIFFS@ero-ks.org), apo përmes faksit, apo me letër të shënjuar për vëmendjen e Departamentit të tarifave & Çmimeve dhe /apo Ekspertit për Ngrohje Qendrore.